UNIVERSITETI I MITROVICES "ISA BOLETINI"

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROCESVERBAL MBI ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI

Nr.prot 301 Datë 13.10.2016

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" më 10.9.2016 shpalli konkurs për pranimin e një mësimdhënësi për lëndët:

- Histori kombëtare;
- Historia e arsimit kombëtar.

Komisioni vlerësues konstatoi që kanë aplikuar këta kandidatë:

1. Sabit Syla;
2. Naim Seferi;
3. Mustafë Haziri;
4. Ardian Emini;
5. Pajazit Hajzeri.

Pas shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, komisioni konstaton që:

**I. Këta kandidatë nuk i plotësojnë kushtet:**

1. Naim Seferi e ka dosjen e pakompletuar (i mungon diploma e studimeve themelore dhe doktoratës).
2. Mustafë Haziri nuk ka dëshmi për kryerjen e doktoratës.
3. Ardian Emini nuk i ka noterizuar kopjen e diplomës master dhe Vendimin për nostrifikimin e diplomës së doktoratës.
4. Pajazit Hajzeri është i kualifikuar në trashëgimi kulturore dhe arkeologji dhe nuk është i fushës për të cilat është shpallur konkursi.

**II. Ky kandidat i plotëson kushtet:**

1. Sabit Syla, i cili ka shkollimin dhe profilizimin adekuat, punimet shkencore dhe përvojen e nevojshme në mësimdhënie. Mbi të gjitha, ka thirrjen akademike "bashkëpuntor i lartë shkencor" në Institutin e Historisë "Ali Hadri", e që sipas nenit 31, paragrafit 2 të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Nr. 4/L-135) është i barazvlefshëm me titullin profesor i asocuar në universitet.

Komisioni vlerësues konstaton se kandidati ka thirrjen adekuate të paraparë me ligj dhe nuk ka arsye të shkruhet përsëri recenzion për të, por thirrja e tij akademike (profesor i asocuar) vetëm duhet të transferohet (barazvlerësohet) në Fakultetin e Edukimit - Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".

Komisioni vlerësues,

1. Prof. asoc. Nuri Buxheti, kryetar _____
2. Prof. dr. Ibrahim Gashi, anëtar _____
3. Prof. dr. Beqir Sadikaj, _____

UNIVERSITETI I MITROVICËS • UNIVERSITY OF MITROVICA
FAKULTETI I EDUKIMIT
ISA BOLETINI

# UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

# RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

# PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

| Fakulteti | I EDUKIMIT |
|---|---|
| Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi | Mësimdhënës për lëndët: Histori kombëtare; Historia e arsimit kombëtar. |
| Kandidatët e paraqitur: | Sabit Syla; Naim Seferi; Mustafë Haziri; Ardian Emini; Pajazit Hajzeri. |

Komisioni vlerësues

| | |
|---|---|
| 1. Kryetar | Prof. dr. Nuri Bexheti |
| 2. Anëtar | Prof. dr. Ibrahim Gashi |
| 3. Anëtar | Prof. dr. Beqir Sadikaj |

**Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti**
**Kandidati 1**

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri | Sabit Syla |
| Datëlindja dhe vendlindja | 08.06.1976, Skenderaj |
| Grada shkencore | Dr. sc |
| Titulli akademik (nëse është rizgjedhje) | Bashkëpunëtor i lartë shkencor |
| Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje) | 31.10.2013 |
| Universiteti/fakulteti/departamenti | Instituti i Historisë "Ali Hadri" |
| **Arsimimi i lartë** | |
| Studimet themelore-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare | Universiteti i Tiranës, dega e historisë, mësues i shkollës së mesme me specialitet të parë histori e të dytë gjeografi, 1999 (vendimi për nostrifikim me nr 6/2406, i datës 27.9.2013 |
| Studimet master/Magjistraturë-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare | Universiteti i Tiranës, dega e historisë, master në histori, 2004 (vendimi për nostrifikim me nr 6/2407, i datës 27.9.2013 |
| Studimet e doktoraturës-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i doktorrimit, (nostrimifikimi nese kandidati ka doktorruar jashte vendit) | Universiteti i Tiranës, dega e historisë, doktor në histori, 2012 (vendimi për nostrifikim me nr 6/2986, i datës 27.9.2013 |

1. **Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit, Tabela 1.**

Përmbledhja e kategorive dhe e numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore (*në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet më të rëndësishme të kandidatit bazuar në CV-në e tij*)

| | Numri i publikimeve | |
|---|---|---|
| **Veprimtaria shkencore e kandidatit** | **Nga fillimi i karrierës** | **Në 4 vjetët e fundit (për assientë në 3 vjetët e fundit)** |
| Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor* | | |
| Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si koautor | | |
| Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si autor kryesor | 20 | 15 |
| Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si koautor | | |
| Publikimet në kongreset ndërkomb. si "proceedings"; autor kryesor | | |
| Publikimet në kongreset ndërkombëtare si "proceedings"; koautor | | |
| Ligjërata në konferenca dhe në universitete të BE (si ligjërues i ftuar) | 2 | 2 |
| Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë | 12 | 8 |
| Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon | 8 | 8 |
| Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkomb. si autor kryesor | 22 | 13 |
| Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si koautor | | |
| Monografitë shkencore si autor kryesor | 3 | 3 |
| Monografitë shkencore si koautor | | |
| Librat universitare në lemin e ekspertizës si autor kryesor | | |
| Librat universitare në lemin e ekspertizës si autor kryesor | | |

| | | |
|---|---|---|
| Recenzent në revistat me "impact faktor" | | |
| Recenzent në revistat pa "impact faktor" | 40<br>**P. S. Kryeredaktor** | 33 |
| Shërbime në lidhje me Fakultetin | | |
| Shërbime në lidhje me Universitetin | | |
| (Kontribute të tjera shkencore dhe artistike) dispenca per studente te studimeve themelore –Master | 1 | 1 |

## Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 1.

*(Komisioni vleresues duhet të japë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impact factorin" e revistës, shtepinë botuese, "impact factorin" personal, etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbeshtetëse për të dhënat e paraqitura duhët të bashkëngjiten në këtë raport)*

Dr. Sc. Sabit Syla ka sjellur dëshmi për këto publikime:

- Faktori ndërkombëtar: nxitës apo frenues për bashkim kombëtar gjatë luftës së dytë botërore, International Journal of Albanology, ISSN 1857-9485 (print), 1857948;
- Drenica gjatë luftës së parë botërore, revista Scupi, Instituti për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, vëllimi 7, 2014, ISSN 978-6084653-21-9;
- Drenica në fund të luftës së dytë botërore, studime për historinë ushtarake, 8 (2014) 2, Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, ISSN: 2305-5073;
- Rexhep Mitrovica – atdhetar i devotshëm i cështjes kombëtare, 2008, Kosova 29/30, Instituti i Historisë – Prishtinë;
- Vështrim mbi lëvizjen nacionalçlirimtare të drenices, shoqata trojet e arbrit, korrik 2008, e djathta shqiptare në mbrojtje të shqipërisë etnike;
- Ceshtja kombëtare e Kosovës në fokusin e politikes gjatë viteve 60' të shekullit XX, organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, seminari i 3-TË, 2009;
- Fazli Berani, luftëtar e strateg në lëvizjen kombëtare shqiptare, shoqata trojet e arbrit, korrik 2010, e djathta shqiptare në mbrojtje të shqipërisë etnike;
- Bashkëpunimi Kosovë – Shqipëri, 2014, Kosova 39, Instituti i Historisë – Prishtinë;
- Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, përmbledshje studimesh, organizuar nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" dhe Instituti i Historisë Toranë, 2014.

Kandidati po ashtu ka qenë kryeredaktor i shumë botimeve të Institutit të Historisë "Ali Hadri". Po ashtu, ka shkruar disa shkrime në gazetat ditore.

**Punimet relevante të kandidatit*, Tabela 2.**

Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit, të cilat e tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar.

| Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet, vegeza | "Impact factor" | Pa "Impact factor" | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|
| 1. "Rexhep Mitrovica - atdhetar i devotshëm i çështjes kombëtare", *Kosova*, Instituti i Historisë, Nr. 29/30, Prishtinë: 2008 | | X | |
| 2. "Vështrim mbi Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Drenicës", *E Djathta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë Etnike - (7),* Prizren - Ferizaj: 2009. | | X | |
| 3. "Fazli Berani, luftëtar e strateg në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare", *E Djathta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë Etnike-(8),* Prizren: 2010. | | X | |
| 4. "Çështja Kombëtare e Kosovës në fokusin e politikës së shtetit shqiptar gjatë viteve '60 të shekullit XX", *Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë,* Universiteti Shtetëror i Tetovës-Maqedoni: 2009. | | X | |
| 5. "Dokumente diplomatike të Qeverisë shqiptare për qëndrimin e Turqisë ndaj Demonstratave të vitit 1981", *Kosova*, Instituti i Historisë, Nr. 30/31, 2011. | | X | |
| 6. "Qëndrimi i Shqipërisë ndaj Demonstratave në Kosovë më 1968", *Studime historike*, Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2012 (3 -4), Tiranë:2013. | | X | |
| 7. "Faktori ndërkombëtar: nxitës apo frenues për bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore", *ALBANOLOGJIA, International Journal of Albanology*, 1-2/2014, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2014. | | X | |
| 8. "Drenica gjatë Luftës së Parë Botërore", *SCUPI*, Vëllimi 7, 2014, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptareve-Shkup: 2014. | | X | |
| 9. "Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore", *Studime për historinë ushtarake*, 8 (2014) 2, Instituti i Historisë së Studimeve Ushtarake, Tiranë: 2014. | | X | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10. "Bashkëpunimi Kosovë-Shqipëri", *Kosova*, Instituti i Historisë, Nr. 39, Prishtinë: 2014. | | X | |
| 11. "Lufta e UÇK-së, në Zonën Operative të Shalës", Vjetari, Arkivi i Kosoves, Prishtinë: 2014. | | X | |
| 12. "Qëndrimi i forcave kryesore politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore", *Shqiptaret gjate Luftes se Dyte Boterore* (*Permbledhje studimesh*), Instituti i Historisë-Prishtinë dhe Instituti i Historise-Tirane, 2014. | | X | |
| 12 "Zona e pushtimit austro-hungarez në Kosovë". *Shqiptarët në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore 1914- 1918*, (*Permbledhje studimesh*), Instituti i Historisë dhe Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015. | | X | |
| 13."Qëndrimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë ndaj ripushtimit të Kosovës", *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*", Instituti i Historisë dhe Tiranes, 2015. | | X | |
| *14.* "Dimensioni historik i figurës së Adem Demaçit", *Veprimtaria atdhetare dhe intelektuale e Adem Demaçit*, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2016. | | X | |
| *15.* "Rezistenca kundër vendosjes së pushtetit komunist në regjionin e Shalës (1944-1947)", *70-vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH-së*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptareve në Shkup dhe Instituti i Historisë-Prishtinë, 2016. | | X | |

*Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojne kriteret e përcaktuara në Statutin e UMIB -it (nenet përkatëse: 155, 156, 157, 158, 159 dhe 160). Nese punimet kane impact faktore shenohet* ***vlera e tij*** *ne te kunderten shenohet shenja* ***X*** *te rubrika pa impact faktore. Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.* Komisioni vleresues mund te barasvleresoj 2 punime si koautor me 1 punim si autor kryesor *Kryetari i komisionit mund të ftohet nga Komisioni i studimeve për shpjegime plotësuese lidhur me raportin e recensionit. Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t'i dorëzohen si dëshmi Komisionit të studimeve së bashku me raportin e recensionit.*

## *Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2.*

*(Komisioni vlerësues komenton/diskuton të dhënat e paraqitura në tabelën e mësiperme, duke dhënë informata për: revistën në të cilën ka botuar autori (duke pasur kujdes që të bëhet dallimi i revistës me recension ndërkombëtar dhe me faktor impakti me revision e cila botohet jashtë Kosovës, por nuk ka recension ndërkombëtar dhe faklor impakti), "impact factorin" e revistës, shtëpinë botuese, "impact factorin" personal, etj. duke men» parasysh fushën e publikimeve dhe lëndët në të cilat konkurron kandidati. Komisioni duhet të interpretojë dhe të diskutoje edhe statusin e kandidatit në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj). Anetarët e komisioneve vlerësuese duhet të kenë kujdes që pjesëmarrja në konferenca dhe abstraklet nga konferencat, nuk mund të paraqiten si punime shkencore. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur, i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport)*

X

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

*(Ne këtë pjesë të raportit shenohën gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, universitetet ku ai ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).*

Kandidati ka përvojë në mësimdhënie:
1999-2007, profesor i histrosë në Gjimnazin Frang Bardhi – Mitrovicë;
2014-2016, ligjërues në Fakultetin Juridik dhe atë të Edukimit – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"

## 3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udheheqese, projektet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, statusi i tij në projekt, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).*

Kandidati ka një përvoje menaxhuese të begatshme, ku aktualisht është drejtor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë.

## 4. Mobiliteti i kandidatit

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qellime pedagogjike shkencore, qendrime: hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse per te dhenat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).*

X

## 5. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

*(Anetarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për nje kandidat për nje pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlëresues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërse 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për te gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).*

Komisioni duke u bazuar në nenin 156 të Statutit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", propozon Dr. Sc. Sabit Syla për

PROFESOR I ASOCUAR

Komisioni erdhi deri të ky propozim-vendim pasi që kandidati i plotëson të gjitha kushtet për tu zgjedhur profesor universiteti:

1. Ka gradën shkencore doktor shkence;
2. Ka profilizim të ngushtë me lëndët në të cilat është bazuar konkursi;
3. Ka punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare dhe vendore konform statutit të universitetit;
4. Ka përvojë në mësimdhënie konform Stautit të Universitetit;
5. Dokumentacionin e aplikimit e ka të kompletuar sipas kërkesës së konkursit.
6. Mbi të gjitha, ka thirrjen akademike "bashkëpunëtor i lartë shkencor" në Institutin e Historisë "Ali Hadri", e që sipas nenit 31, paragrafit 2 të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Nr. 4/L-135) është i barazvlefshëm me titullin profesor i asocuar në universitet.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Prof.asoc. Nuri Bexheti, Kryetar _____
2. Prof.dr.Ibrahim Gashi, anëtar _____
3. Prof. dr. Beqir Sadikaj, anëtar _____

Datë: